



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.47, datë 30.07.2007

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.15,
DATË 10.03.2004 “PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E PAGAVE
TË DREJTORISË NR.3 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika3/II, gërma “c”, neni 11, pika 3, gërma “e”, neni 32, gërma “ç”, V.K.M. Nr.285, dt.04.05.2007 “Për caktimin e pagës referuese për efekt të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale”, Ligjin Nr.7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, manualin “Mbi analizat teknike për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, miratuar nga Ministria e Ndërtimit në muajin Maj të vitit 1992, V.K.B. Nr.15, dt.10.03.2004, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve & Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë një ndryshim në lidhjen nr.4, (pika 5), të V.K.B. Nr.15, dt.10.03.2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, si më poshtë:

Ishte

V. Punëtorë sezonal (3 muaj)	30 punëtorë
- lyerje me hidromat	35 lekë/m ²
- lyerje me gëlqere	20 lekë/m ²

Bëhet

V. Punëtorë sezonal (3 muaj)	60 punëtorë
------------------------------	-------------

- Lyerje me gëlqere

Normative sipas manualit	0.16 orë/m ²
Paga orar (V.K.M. Nr. 285)	139.15 lekë

Çmimi 20 lekë/m²

- Lyerje e brendshme (hidromat, plastiko, bojë vaji)

Normative sipas manualit	0.36 orë/m ²
paga orare (V.K.M. Nr.285)	139.15 lekë

Çmimi 50 lekë/m²

- Suvatim fasade

Normativa sipas manualit 2.3 orë/m²

Paga orare (V.K.M Nr.285) 139.15 lekë

Çmimi 320 lekë/m²

- Lyerje fasade (plastiko-akriliko)

Normativa sipas manualit 0.96 orë/m²

Paga orare (V.K.M Nr.285) 139.15 lekë

Çmimi 133.6 lekë/m²

2. Efektet financiare të këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit për vitin 2007, duke pakësuar fondin e shpenzimeve operative të artikullit (602) në shumën 9.939.000 lekë dhe duke shtuar respektivisht fondin e pagave në artikullin (600) në shumën 8.166.700 lekë dhe fondin e sigurimeve shoqërore në artikullin (601) në shumën 1.772.300 lekë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R